

1921
7.11.22

"HEC ARSTI" shpk, NIPT: L61601028F

Adresa: Njësia Administrative Fierzë, Bashkia Fushë Arrëz, Nr.Pasurisë 233/1, Zona Kadastrale nr.1054, Vol.2, Faqe 39.

Nr. 75 Prot

Datë 07/11/2022

Lënda: Kërkese për zgjatje afati të plotësimit të elementëve të pikës së lidhjes

Drejtuar: Enti Rregullator i Energjisë (ERE)

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri, Rruga Viktor Eftimiu 1023, TIRANË

I nderuar z. AHMETI,

Shoqëria "Hec Arsti" është zotëruese e "Hec Arsti", ndodhet në përroin e Arstit, Fierzë, Bashkia Fushë Arrëz, me fuqi të instaluar 3.130 MW, licensuar në ERE me vendimin e Bordit nr.218, datë 20.12.2019, për prodhimin e energjisë elektrike Seria P19, dhe numër licence 456.

Me Vendimin nr.185, datë 13.11.2020 "Mbi shqyrtimin e Kërkesës për derogim të shoqërisë Hec Arsti sh.p.k.", Bordi i ERE ka miratuar derogimin e kërkuar në dy faza implementimi. Në fazën e parë parashikohet që trakti 110kV i linjës të pajiset me thikë ndarëse për një periudhë 24 mujore dhe në përfundim të këtij afati trakti 110kV të pajiset me të gjithë elementet e nevojshëm thikë dhe çelës.

Sipas pikës 4.5.1, të Rregullores së procedurave për lidhjet me rrjetin e transmetimit, në të gjitha rastet kostot për lidhjen me rrjetin e transmetimit përballohen nga aplikuesi.

Gjatë periudhës 24 mujore shoqëria ka zbatuar kërkesat e parashikuara në fazën e parë, trakti 110kV është pajisur me thikë ndarëse, si dhe ka lidhur Marrëveshje për lidhjen me rrjetin e transmetimit të Hec Arsti, me OST sh.a.dhe me OSHE sh.a., si dhe po punojme për plotësimin e elementeve të pikës së lidhjes sipas parametrave të vendosur nga OST sh.a.

Në vitet 2020-2022 shoqëria ka qënë në vështirësi financiare, si pasojë e pandemisë, dhe si pasojë e rritjes së çmimeve të pajisjeve dhe elementëve të nevojshme të lidhjes me rrjetin e transmetimit për shkaqe të luftës.

Në këto kushte të vështirësive që kemi hasur, kërkojmë zgjatje të afatit të plotësimit të traktit 110 kV me paisjet dhe elementët e nevojshëm për një periudhë shtese 24mujore.

Bashkelidhur kemi vendosur dokumentacionin për energjizimin e HEC Arsti me rrjetin e transmetimit si dhe Akt-Marreveshjet me OST.sh.a. dhe OSHE sh.a.


Me Respekt.

HEC ARSTI

Administratori i firmës,

"Klaudio PRENDI" sh.p.k.





OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DEPARTAMENTI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PLANIFIKIM ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT

Nr. 7919 prot.

Tiranë, më 29.12.2020

Lënda: Mbi ecurinë e punimeve për energjizimin e HEC Arsti me rrjetin e transmetimit

Z. Lulëzim Pepa
ADMINISTRATOR
HEC ARSTI Sh.p.k.

Nj.Bashkiake Nr.9, Rr.Urani Pano, Pll. Nr.11, K.2, Zyra Nr.2, Tiranë

Në vijim të procedurave për lidhjen e HEC Arsti me rrjetin e transmetimit, me fuqi totale të instaluar prej 4 MW, është ngritur grupi i punës që do të kryejë inspektimet e punimeve për infrastrukturën lidhëse me rrjetin e transmetimit. Sipas ecurisë së punimeve, grupi i punës i OST sh.a. ka kryer më datë 23-24.12.2020 inspektimin në terren të punimeve. Pas kontrollit dhe verifikimeve të kryera në prani të përfaqësuesve të shoqërisë HEC Arsti sh.p.k., dëshirojmë t'ju bëjmë me dije me komentet/konstatimet si më poshtë:

Për pajisjet primare:

1. Pajisjet primare ishin të vendosura në zbatim të Rregullores së Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes së Pajisjeve. Testet në fabrikë dhe në objekt të pajisjeve primare rezultojnë brenda normave teknike. Tabelat e Sigurimit Teknike në rrethim dhe portale janë vendosur. Shoqëria të dorëzojë zyrtarisht dosjen teknike (testet FAT, Rezistencën e tokëzimit, testet SAT) për pajisjet primare në OST.

Për pajisjet sekondare dhe Mbrojtja Rele:

1. Për sa i takon pajisjeve të mbrojtjes rele, nga inspektimi vihet re se kontraktori ka realizuar volumin e punimeve për sa i takon instalimit të paneleve të Mbrojtjes Rele, të Pajisjeve të Kontrollit dhe Marshalling Kiosk-ave respektive për dy traktet e linjës dhe një trakt transformatori. Gjithashtu janë shtruar kabllot sekondarë respektivë për dy traktet e linjave dhe traktin e transformatorit të fuqisë.

Kontraktori ka instaluar në panelin e Mbrojtjes Rele për Transformatorin 110/6,3 kV Mbrojtjet Rele të nevojshme. Konkretisht janë përdorur:

- Mbrojtje Diferenciale SIEMENS tip 7UT85
- Mbrojtje Maksimare (Back Up) SIEMENS 7SJ82 të cilat plotësojnë kriteret teknike.

Gjithashtu u kontrolluan komandimet, sinjalizimet dhe interlokimet e të tëra pajisjeve të instaluar si thikë pune, thikë toke, çelës me gaz 110 kV si në lokal dhe në distancë, të cilat rezultuan në rregull.

Për pajisjet e Matjes Tregtare:

Për sa i përket pajisjeve të matjes tregtare nga inspektimi vihet re se kontraktori ka realizuar volumin e punimeve për sa i përket instalimit në panele dhe instalimit në tërësi si më poshtë:

1. Të dhënat teknike të pajisjeve primare: Transformatorët e rrymës dhe tensionit, të instaluar në traktin e transformatorit të fuqisë nga ana 110 kV të dedikuar për matjen, përputhen me kërkesat e Kodit të Matjes.
2. Instalacionet dhe pajisjet e përdorura (boks+matës+kabllime+pajisje komuntuese) janë të instaluar në përputhje me kërkesat teknike të kërkuara nga Kodi i Matjes dhe Kodi i Rrjetit të Transmetimit.
3. Të dhënat e matësave të energjisë mund të dërgohen në QME (Qendra e Menaxhimit të Energjisë), nëpërmjet sistemit GSM Data, GPRS Data.
4. Janë dorëzuar pranë OST çertifikatat e transformatorëve të rrymës dhe tensionit, çertifikatat e matësave të energjisë elektrike, projektin elektrik të sistemit të matjes dhe Test Raportet e kryera në nënstacion.

Për sistemin SCADA/EMS:

Për sa i përket sistemit SCADA/EMS, nga inspektimi u evidentua që ky sistem nuk transmeton ende të dhëna në sistemin SCADA qëndror pasi nuk është konfiguruar akoma ndërfaqja me protokollin IEC 104 të sistemit lokal. Janë realizuar instalimet e sistemit SCADA lokal dhe është funksional për këtë pjesë.

Për sistemin e Telekomunikacionit:

Për sa i përket sistemit të Telekomunikacionit, nga inspektimi vihet re se janë realizuar volume e punimeve për instalimin e trosit optic OPGW nga shtylla ku bëhet lidhja me rrjetin e transmetimit deri në portalin e N/Stacionit pranë HEC Arsti.

Sa i takon furnizimit dhe instalimit të pajisjes së telekomunikacionit rezulton se volume i punimeve nuk është realizuar në këtë fazë.

Për punimet civile:

Nga inspektimi u konstatua se janë kryer punime ndërtimore në betonimin e bazamentit të transformatorit të fuqisë, bazamentet e konstruksioneve metalike për shkarkuesit dhe transformatorit të kombinuar, bazamentet e çelsit të fuqisë, rrethimi i jashtëm dhe shtresa me zhavor i gjithë territorit të nënstacionit. Në bazamentin e transformatorit të fuqisë mbetet për t'u vendosur zgarë metalike dhe çakulli sipër saj.

Për pjesën e linjës 110 kV:

Për linjën ajrore 110 kV me dy qarqe janë kryer volumet kryesore të punës. Duhet të dorëzohen në OST Test Raportet për matjes e distancës së përcjellsve me rrugën për të

gjithë kampatat e reja të linjës dhe Prooes-Verbalet e matjes së rezistencës së tokëzimit të shtyllave të reja të vendosura në linjë.

Për sa më sipër, grupi i punës së OST sh.a. miraton lidhjen e HEC Arsti me Sistemin e Transmetimit nëpërmjet çarjes së linjës 110 kV Fierzë – Dardhë dhe energjizimin e N/Stacionit 110/6,3 kV HEC Arsti.

Për zgjidhjen e problemeve dhe plotësimin e mangësive të sipër përmendura i lihet HEC Arsti shpk një afat 3 (tre) mujor për plotësimin e tyre. Shoqëria HEC ARSTI shpk, mbas afatit të përcaktuar, duhet të informojë OST sha për plotësimin e tyre nëpërmjet komunikimit zyrtar shkresor.

Me respekt,

ADMINISTRATORI i OST sh.a.


Skerdi Drenova



Tiranë më 29/12/2020

Drejtuar
Z.Skerdi Drenova
Administrator i OST SHA

Per Dijeni
Z.Blendian Dalipi
Drejtori i DRRT

Per Dijeni
Z.Luan Aranitasi
Drejtor i DOS

Lenda. Akt Inspektimi dhe informacion per Lidhjen e Hec Arsti me Rrjetin e Transmetimit

Emërtimi i objektit:

“HEC ARSTI 110/6.3 kV “.

Në zbatim të Urdherit te brendeshem të Administratorit të OST sh.a Nr.7764 Prot. datë 21-12/2020; URDHËR Nr.377, datë 21/12/2020, “Për ndjekjen e punimeve per lidhjen e Hec Arsti me rrjetin e transmetimit grupi i punes i perbere nga:

Antonion Shkurti (Sektori i Mbrojtjes Rele)

Florjan Fusha (Sektori i Matjes se Energjise)

Dritan Smaka (Sektori i Nenstacioneve)

Rejnald Zyfi (Sektori i Projekteve)

Nigela Vavako (Sektori i Projekteve)

Fisnik Ponari (Sektori i SCADA EMS)

Indrit Barbullushi (Sektori i Operimit dhe Mirembajtjes se Rrjetit te Telekomunikacionit)

ne datat 23-24-12-2020 beri inspektimin respektiv ne Objekt dhe sa me poshte konkludon :

Per Paisjet primare :

Paisjet primare ishin të vendosura ne zbatim te Rregullores se Shfrytezimit dhe Mirembajtjes se Pajisjeve. Testet ne fabrike dhe ne objekt te pajisjeve primare rezultojne brenda normave teknike. Tabelat të Sigurimit Teknik në rrethim dhe portale ishin vendosur; Shoqeria te furnizoje zyrtarisht ne OST sh.a dosjen teknike (testet FAT,Rezistencen e tokezimit ,SAT projektet primare).

Për Paisjet sekondare dhe Mbrojtja Rele :

Per sa i perket pajisjeve te mbrojtjes rele ne HEC ARSTI nga inspektimi vërejme se kontraktori ka realizuar volumin e punimeve per sa i perket instalimit te Panelit te Mbrojtjes Rele,instalimit te Panelit te Paisjeve te Kontrollit dhe Marshalling Kioskave respektive per dy trakte linje dhe nje trakt transformatori.Gjithashtu jane shtruar edhe kablrot sekondar respektiv per dy traktet e linjave dhe traktin e transformatorit te fuqise.

Kontraktori ka instaluar ne Panelin e Mbrojtjes per Transformatorin 110/6.3kV Mbrojtjet Rele te nevojshme.

Mbrojtjet Rele qe jane Perdorur jane:

1-Mbrojtje Diferenciale SIEMENS tip 7UT85

2-Mbrojtjes Maksimale Rezerve SIEMENS 7SJ82 te cilat plotesojne kerkesat teknike.

Gjithashtu u kontrolluan komandimet dhe sinjalizimet interlokimet e te tera pajisjeve te instaluar si thika pune, thika toke, celes me gaz 110kV si ne lokal dhe ne distance dhe rezultuan OK.

Per Paisjet e Matjes Tregtare :

Përsa i përket pajisjeve të matjes tregtare nga inspektimi vërejme se kontraktori ka realizuar volumin e punimeve për sa i përket instalimit në panele dhe instalimit të tyre si më poshtë:

1. Të dhënat teknike të pajisjeve primare: Transformatorët e rrymës dhe tensioni, të instaluar në traktin e matjes së transformatorit të fuqisë nga ana 110kV, përputhen me kërkesat e Kodit të Matjes.
2. Instalacionet dhe pajisjet e përdorura (boks + mates + kabllime + pajisje komunikuese) janë të instaluar në përputhje me kërkesat teknike të kërkuara nga Kodi i Matjes dhe nga Kodi i Rrjetit.
3. Të dhënat e matësave të energjisë mund të dërgohen në QME (Qendrën e Menaxhimit të Energjisë), nëpërmjet sistemit GSM Data, GPRS Data.

Per sa me siper grupi i punes i OST-Sha miraton lidhjen e HEC Arsti me Sistemin e Transmetimit duke çare linjen 110kV Fierze-Fushe Arrez dhe energjizimin e Nenstacionit 110kV HEC Arsti.

Per zgjidhjen e problemeve dhe plotesimin e mangesive te siperpermendura i lihet HEC Arstit nje afat 3 mujor per plotesimin e tyre.

Hec Arsti mbas afatit te percaktuar duhet te informoje me shkrese OST-Sha per plotesimin e tyre.

Për OST sh.a Grupi i Punes

Antonion Shkurti

Florjan Fusha

Dritan Smaka

Rejnald Zyfi

Indrit Barbullushi

Nigela Vavako

Fisnik Ponari